

**BOTIM ME VLERË MBI SHKENCËRIMIN
E PËRDITSHMËRISË**

Billy Ehn, Orvar Löfgren dhe Richard Wilk, “Exploring Everyday Life. Strategies for Ethnography and Cultural Analysis” (“Eksplorimi i jetës së përditshme. Strategjitë për Etnografinë dhe Analizën kulturore”), botoi: Rowman & Littlefield në Lenham, Boulder, New York, London, 2016, 153 f.



Kur ne (hulumtuesit, studiuesit apo studentët e rinj) jemi në fazën e fillim-kërkimit të ideve për një temë të caktuar, kemi nevojë të mësojmë artin e analizës së një kulture në një mënyrë sa më të kapshme e të thjeshtë dhe ky libër është ai që e plotëson këtë boshllëk, duke na dhënë shembuj konkretë e të mirilustruar. Për më tepër, ky libër na jep udhëzime se si mund t'i gjurmojmë rutinat që njerëzit i praktikojnë dhe i natyralizojnë në diçka të dukshme dhe të prekshme në jetën e përditshme, sikurse kur rutinat zhyten në trup dhe ato kthehen në refleksë. “Eksplorimi i jetës së përditshme” paraqitet si një “guidë eksploruese” me një strukturë të pasur hap pas hapi, që na ndihmon

t'i gjenerojmë së pari idetë, teoritë, literaturën, materialet, metodat e teknikat që janë të nevojshme për ta trajtuar një temë të caktuar, qoftë ai një punim seminarik, qoftë një temë masteri, qoftë një disertacion, duke na ndihmuar të vijmë deri te rezultati. Por, pse ky interesim për jetën e përditshme? Pse ky terren i përditshmërisë? Sepse në këtë mënyrë, sipas autorëve, kuptohen dhe mund të analizohen më mirë sjelljet njerëzore, mjedisi i tyre, rutinat, vetitë, angazhimet dhe praktikimi i ritualeve të përditshme (larja e dhëmbëve në mëngjes, ngrënia e vakteve, angazhimi në punë, përdorimi i teknologjisë, etj.) që nënkupton analizën e fenomeneve kulturore të krijuara në baza të përditshmërisë.

Botimi i vitit 2016 nga tre autorë - Billy Ehn (Profesor emiritus në Universitetin Umeå të Suedisë), Orvar Löfgren (Profesor emiritus në Universitetin e Lund-it në Suedi) dhe Richard Wilk (Profesor emiritus në

Universitetin Indiana në Bloomington /Indiana) - sjell një libër me 9 kapituj shumë përmbajtësorë e me një gjuhë të thjeshtë shkencore dhe lehtë të kuptueshme për çdo hulumtues. Duke filluar nga kreu i parë i këtij libri “Hidden Worlds” (Botë të fshehta), ky botim eksploron dhe shpjegon se si misteret e jetës së përditshme nga bisedat dhe vëzhgimet përmes shfletimit të internetit dhe kulturave popullore mund të bëhen baza të etnografisë së pasur dhe analizave të thella kulturore. Gjithashtu, është e rëndësishme që të kemi të qartë qasjen metodologjike, teknikat e mbledhjes së materialeve, që mund të shoqërohen nga intervistat, observimet/ vëzhgimet dhe procedurat e tjera, që hulumtuesi ndërmerr gjatë prezencës në terren.

Kapitulli II, “The Importance of Small Things” (Rëndësia e gjërave të vogla) flet për detajet e vogla, por të rëndësishme për një hulumtim mbi jetën e përditshme. Autorët përshkruajnë pesë hapat e definuar që ndihmojnë në procesin e analizës kulturore dhe etnografisë; Fillimisht, kur hulumtuesi e zgjedh një qëllim dhe bën një pyetje të problemit, mbi të cilin do të tentojë të argumentojë se çfarë do të shtjellojë dhe cilat nga metodat dhe teoritë do të përdorë; shtjellimi i literaturës; mbledhja e të dhënave empirike; analiza, dhe e fundit, përmbledhja në letër apo shkrimi i punimit.

“Making the Familiar Strange” (Duke bërë të njohurën të panjohur/ të huaj) është kapitulli i radhës, që përshkruan fenomenin që një studiues

/hulumtues duhet të ketë aftësi që një problem tashmë të njohur, të dijë ta shohë edhe me një sy tjetër, në një kontekst të ri, sikurse e kemi shembullin me “shtëpinë” si një koncept tashmë i njohur, por që lehtë mund të shihet dhe t’i jepet kontekst tjetër studimor.

Kështu, autorët e këtij libri theksojnë rëndësinë e analizimit të gjërave të përditshme, sikurse kemi rastin në kapitullin IV “Sharing a Meal” (Ndarrja e vaktit). Në këtë kapitull theksohet nga autorët se sa shumë mund të analizohet dhe të mësohet vetëm duke vëzhguar aktin e thjeshtë të ngrënies me familje apo me një rreth tjetër shoqëror. Ky akt i ngrënies në familje, ndryshon duke pasur parasysh kombinimin e pritshmërive kulturore, historinë familjare, nivelin shoqëror e ekonomik, pushtetin gjinor që shfaqet që nga ulja rreth tavolinës së bukës e edhe gjatë ngrënies etj.

Kapitulli V shtjellon temat shumë aktuale të përdorimit të platformave të ndryshme të internetit dhe nënvizon rolin dhe përdorimin e medias në jetën e përditshme e sidomos në ambientet e brendshme të shtëpisë. Është karakteristike se si autorët tentojnë të sjellin edhe një krahasim në mes të jetës në të kaluarën dhe jetës tash, jetës digjitale dhe asaj analoge dhe përdorimit të përditshëm të teknologjisë.

Në kapitullin e radhës, autorët flasin për atmosferën që mbizotëron në një hapësirë të caktuar. Në këtë kapitull, theksi bie mbi jetën publike dhe analizimin e personave në lëvizje në një pjesë të caktuar publike. Dy temat kryesore në këtë kapitull kanë të

bëjnë me metodat që përdoren për të studiuar atmosferën dhe materialet me të cilat mund të studiohet një temë e tillë, pasi këtu bëhet fjalë për ndjenjat, disponimin dhe atmosferën, gjëra që, po nuk i përshkruam në ditarin hulumtues në atë moment, është vështirë të shpjegohen më vonë.

Në kapitujt e fundit autorët theksojnë rëndësinë e shkrimit etnografik, rëndësinë e çmitizimit të hulumtimit në terren, dhe rëndësinë e pjesës analitike të studimit. Për të arritur në fazat finale të një studimi, sipas autorëve të këtij libri, duhet që ne ta zotërojmë aftësinë e shkrimit, që mbi të gjitha, e shohin si një kombinim të mirë rrëfimin narrativ (storytelling) personal me një gjuhë analitike, por shumë strikte. Ndër të tjera, vihet në pah edhe një metodë e mirë hulumtuese, e që është autoetnografia, e cila po rekomandohet gjatë viteve të fundit. Në shumë studime, hulumtuesi e përdor veten si një vegël hulumtuese për të përshkruar dhe kuptuar fenomenet e ndryshme, por pa e bërë këtë si metodë kryesore të hulumtimit.

Billy Ehn-i, në kapitullin VII, thekson edhe frikën ndaj dështimit që studentët dhe studiuesit në përgjithësi mund ta përjetojnë gjatë procesit të hulumtimit apo shkrimit analitik. “Pavarësisht se kam botuar shumë libra dhe artikuj, shkrimi i këtij kapitulli ka hasur në trajtimin e problemeve të tilla edhe për mua” (111) thekson Billy Ehn-i. Mënyra më e mirë e menjanimin të kësaj frike është inkurajimi për të vazhduar përballjen me fjalitë e pakuptueshme në fillim të punimit, rishikimin e punës dhe konsultimin në

vazhdimësi me shokë, kolegë apo mentorë të punimit. Në një kontekst specifik, autorët, ngrisin edhe temën për diskutim të zgjedhjes së hulumtimit në terren apo “Fieldwork”. Ata theksojnë ndryshimin që ka shkaktuar globalizmi dhe zhvillimi i teknologjisë në përgjithësi, dhe specifikisht edhe në ndryshimin e kontekstit të etnografisë. Hulumtimi klasik në terren i bërë kohë më parë (duke udhëtuar në shkretëtira dhe vende ekzotike dhe duke sjellë disa rrëfime të shkruara me vete) është i rrallë. Sot shfrytëzohen të gjitha mjetet teknologjike për të bërë audio-video incizime, dhe platformat e ndryshme të internetit mundësojnë zhvillimin e një hulumtimi, gjë që nënkupton se terreni sot është fleksibil dhe mund të jenë një video-telefonatë në Skype apo vetë platforma e Facebook-ut terrene hulumtimi.

Ky libër i mirëhulumtuar dhe mjaft i lexueshëm për fushën e Etnologjisë rekomandohet për të gjithë studentët, hulumtuesit dhe studiuesit e rinj që, në një mënyrë ose në një tjetër, hasin në vështirësi të zgjedhjes së temave, ideve, metodave fillestare të një punimi specifik shkencor, të shkrimit akademik, analizës kulturore, apo në hulumtime në terren që kanë për qëllim eksplorimin e përditshmërisë. Me fjalë të tjera, ky libër, që paraqitet me një strukturë të pasur analitike e teorike, sjell kapitujt që përfshijnë strategji qysh në fillimet e para të zgjedhjes së temës e deri te finalizimi i punimit me shkrim, apo edhe publikimi i tij. Ky libër nuk duhet vetëm të lexohet, por edhe të përdoret si një vegël mjaft e mirë, me shembuj shumë praktikë, të

cilët mund të jenë ndihmesë e madhe edhe për etnologët dhe antropologët e rinj shqiptarë që t'i zhvillojnë aftësitë e tyre në hulumtimet e tyre në fushat e shkencave sociale dhe t'i sfidojnë vështirësitë duke përdorur teknika dhe metoda të shtjelluara nga autorët e këtijlibri.

Bubulinë SYLA